

"Unë nuk i përkas Budizmit apo Katolicizmit. Unë i përkas së vërtetës dhe predikoj të vërtetën... ju mund ta quani atë Budizëm, Katolicizëm, Taoizëm, ose ç'farë të dëshironi. Unë i mirëpres të gjitha."

~ Mjeshtrja Supreme Ching Hai ~

"N.q.s. ne gjejmë lirinë e brëndëshme, gjejmë gjithçka tjetër. Tërë kënaqësia dhe plotësimi i dëshirave qiellore dhe tokësore vijnë nga mbretëria e Zotit, realizimi i brëndëshëm i harmonisë sonë të përjetshme, i mënçurisë sonë të përjetëshme dhe i fuqisë sonë të mbinatyrshme. Në qoftë se kjo nuk realizohet, ne nuk do të kënaqemi kurrë, pavarësisht se sa fuqi, para dhe pozitë kemi."

~ Mjeshtrja Supreme Ching Hai ~

"Mësimi ynë është: çfarëdo që keni për të bërë në këtë botë, bëjeni atë me gjithë zemër, me përgjegjësi... dhe meditoni çdo ditë. Ju do të fitoni më shumë njohuri, më shumë urtësi, paqe, me të cilat do ti shërbeni më mirë vetes dhe njerëzimit. Mos harroni që në brëndësinë tuaj keni shumë mirësi... mos harroni që Zoti jeton në ju... mos harroni që Buddha është në zemrat tuaja."

~ Mjeshtrja Supreme Ching Hai ~

Biografi e shkurtër e Mjeshtres Ching Hai

Mjeshtrja Ching Hai lindi në Au Lac (Vietnam). Babai i saj ishte mjek popullor i respektuar. Ai lexonte me shumë kënaqësi literaturë botërore ndërsa veçanërisht ishte i interesuar për filozofi. Përveç tjerash Mjeshtrja pëlqente shkrimet e Lao Tse dhe Chuang Tse, të cilat ju vunë në dispozicion që kur ishte fëmijë. Ajo i kishte lexuar këto shkrime budiste e të tjera që pa filluar shkollën.

Mjeshtrja Ching Hai nuk ishte fëmijë i zakonshëm. Përderisa fëmijët tjerë mësonin ose luanin, ajo lexonte literaturë filozofike. Babai i saj i shqetësuar e pyeste nëse ajo i kuptonte këto vepra apo jo. Ajo i përgjigjej: "Nëqoftëse nuk do ti kuptoja nuk do të kisha asnjë interes të merresha me to." Babai vazhdonte të ishte i shqetësuar, por nga që ajo ishte mirë me mësimet, i përkrahte interesat e saj të jashtëzakonshme.

Megjithëse prindërit e saj ishin katolik, ata e mirëprisnin budizmin. Gjyshja e Mjeshtres Ching Hai, një budiste me të cilën ajo kalonte kohën me shumë kënaqësi, i mësonte asaj shkrimet dhe lutjet budiste. Përpara këtij sfondi ajo krijoi një

qëndrim mirëpritës përkundrejt fesë. Do t'i përcjellte ligjeratat në kishën katolike në mëngjes, në tempullin budist në mesditë, kurse në mbrëmje, ligjeratat për mësimet e shenjta. Kështu i lindën asaj pyetjet: Nga e kemi ne prejardhjen? Si është jeta pas vdekjes? Përse janë njerzit kaq të ndryshëm?

Ishte një kohë që kishte mungesë mjekësh dhe infermjeresh në spitalin e qytetit të saj, ku ajo shkonte mbas mësimit dhe ndihmonte. Ajo lante të sëmurët, pastronte dhomat, kështu ndihmonte për të zvogëluar vuajtjet e të sëmurve. Të njohurit e saj në vende të ndryshme të botës e quanin shpesh "Buddha i gjallë" ose "E shenjta e çiltër" sepse ishte e qeshur dhe e sjellshme me çdo njeri.

Ajo ishte e njohur si njeri që i donte kafshët dhe që shpesh herë i merrte kafshët e plagosura në shtëpi për ti kuruar dhe për ti lënë përsëri të lira. Kur ajo shihte që një kafshë ishte keqtrajtuar, qante dhe uronte që të kishte mundësinë për të shmangur vuajtjet nga kjo botë. Gjatë gjithë jetës së saj ishte vegjetare dhe ndjente neveri kur shihte mish ose se si therej një kafshë.

Që kur Mjeshterja Ching Hai ishte fëmijë, një fallxhore i tha që ajo ishte një qenie e jashtëzakonshme, një qenie shumë inteligjente, me një karakter dhe moral të fortë. Gjithashtu i parashiqoi që n.q.s ajo nuk do të martohej, do të ishte e vetme dhe e ndritësuar; e n.q.s do të martohej do të kishte një lidhje bashkëshortore të lumtur, ndërsa burri i saj do të

ishte një personalitet i shquar. Të njëjtat parashikime iu bënë asaj shpesh gjatë gjithë jetës.

Në kohën kur Mjeshtria u largua nga shtëpia për tu bërë murgeshë, e ëma e saj shkoi në një Kuan Jin tempull për të kërkuar këshilla. Ajo zgjodhi një tempull, për të cilin thuhej se atje Avalokitesvara Bodhisattva u jepte përgjigje të gjitha pyetjeve të njerëzve të cilët e nderonin atë. Aty ajo mori përgjigjen se, "mjeshtria ishte një fëmijë shumë i rrallë dhe fisnik që i gjendet shoku një në një milion. Ajo kishte ardhur në këtë botë, me mision të Kuan Jin-it, për të shpëtuar qeniet e gjalla nga vuajtjet."

Për një kohë të gjatë punoi në Gjermani, si përkthyes pranë kryqit të kuq. Përkthente në gjuhën aulake (vietnameze), franceze, gjermane dhe angleze. Punoi gjithashtu vullnetarisht në ndihmë të refugjatëve aulakë me orë të tëra duke sakrifikuar kështu rehatinë dhe shëndetin e vetë.

Puna pranë kryqit të kuq i bëri të mundur, që të njihej me refugjatë nga vende të ndryshme të botës. Aty njohu nga afër vuajtjet dhe vështirsitë që sillte lufta dhe fatkeqësitë natyrore. Mjeshtria Ching Hai filloi të vuante shumë, kur arriti të kuptonte, se sa e pamundur ishte për një njeri të vetëm të lehtësojë vuajtjet e njerëzimit. Kjo e përforcoi shumë dëshirën e saj për ndritësim, si mënyra e vetme për të lehtësuar vuajtjet e njerëzimit. Gjatë qëndrimit në Europë, ju kushtua seriozisht meditimit, kërkoi mësues të rinjë, lexoi çfarë mundi të gjente dhe përdori një sërë metodash. Por ajo e ndjente, që këto nuk e ndihmonin aspak dhe që ajo nuk

ishte në gjëndje të krijonte ato përvoja shpirtërore, për të cilat kishte lexuar aq shumë. Ky qe një zhgënjim i hidhur për të.

Mjeshtrja Ching Hai i mirëpriste të gjitha llojet e besimeve fetare. Ajo studjoi dhe ju mësonte të tjerëve fjalët e Jesus-it, Buddha-s dhe Lao Tse-së. Ajo vë në dukje ngjashmëritë ndërmjet doktrinaeve me emër dhe lë të kuptosh, nëpërmjet syve të saj, që të gjithë mjeshtrit e mëdhenjë predikonin të vërtetën e njëjtë. Ajo sqaron vazhdimisht, se pikëpamjet e ndryshme fetare janë pasojë vetëm e opinjoneve të ndryshme të njerëzve në vënde të ndryshme të botës dhe në kohëra të ndryshme.

Gjatë vizitës në Gjermani ishte e martuar me një shkencëtar gjerman, i cili kishte marrë titullin doktor në dy fusha të ndryshme të shkencës. Ai ishte një bashkëshort i dashur dhe i kujdesshëm. Ai u bë vegjetar, merte pjesë së bashku me të në shtegëtime të ndryshme dhe përkrahte shumë punën e saj kreative. Ajo ndjeu si përfundim se duhet të ndahej nga burri i saj, për të ndjekur kështu qëllimet e saj shpirtërore. Pas një bisede të hollësishme, të dy u pajtuan që të ndaheshin. Ishte ky një vendim i vështirë për të dy, por ajo e ndjente që kishte vepruar siç duhej, se vetëm kështu mund të kërkonte ndritësimin.

Pas ndarjes, nisi të kërkojë një metodë të plotë, e cila mund të çonte në çlirim brenda një jete. Shakyamuni Buddha thotë në Surangama Sutra, që metoda e Kuan Jin-it, është më e larta e të gjitha metodave, gjë që nuk e njihnte asnjë nga

mësuesit e saj. Pas shumë vjetësh kërkim, arriti të gjente një mësues në zonën e Himalajës, i cili i mësoi për herë të parë metodën e Kuan Jin-it dhe transmisionin e Zotit, gjë që ajo e kishte kërkuar për kaq vjetë me radhë. Pak kohë pas përdorjes së metodës të Kuan Jin-it, arriti ndritësimin e plotë dhe vazhdoi të ushtrohej, për ta kuptuar atë më thellë. Jetoj për një kohë të gjatë e vetmuar në Himalaje, ku dhe vazhdoi të ushtrohej përditë.

Së fundi udhëtoi për në Formosë (Taivan), ku gjatë një tajfuni e një shiu të fortë, ndërsa po meditonte në një dhomë mbrapa një tempulli të vogël, i trokiti një grup njerëzish në derë. Të pyetur përse kishin ardhur, ata u përgjigjën: "Kuan Jin Bodhisattva dëgjoi lutjet tona, na tregoi për ty dhe na tha se ti je mjeshtrja e madhe, të cilës ne duhet ti lutemi për metodën e arritjes së çlirimit." Mjeshtrja u mundua ti largonte, por ata ishin këmbëngulës. Si përfundim, e prekur nga ndershmëria dhe pasioni i tyre, ra dakort që ti pranojë pas disa muajsh pastrimi dhe mbajtjes së një diete vegjetare të miratuar nga ajo vetë.

Ashtu, e ndrojtur si ishte, nuk kërkonte të gjejë nxënës, të cilëve mund t'ju jepte mësim. Përkundrazi, ju desh të ruhej nga njerëzit e shumtë që kërkonin bekimin e saj. Kjo ndodhi në Indi dhe në SHBA, ku ajo bënte një jetë të thjeshtë si murgjeshë budiste. Por kur u zbulua në Formosë për herë të tretë, e kuptoi që nuk mund t'ju fshihej gjithë atyre detyrave që, në radhë të parë, i viheshin asaj nga të tjerët. Ajo filloi t'ju mbante referate njerëzve, të cilët dëshironin të dëgjonin

mesazhin e saj, si dhe t'ju prezantonte nxënësve serioz metodën e Kuan Jin-it.

Që nga ky grup i vogël arriti mesazhi i saj, gojë mbas goje, dhjetramijra njerëz të tjerë. Shumica e të bekuarëve të saj jetojnë në Formosë, ku ajo qëndroi më gjatë. Vitet e fundit udhëtoi nëpër mbarë Azinë, Shtetet e Bashkuara dhe Amerikën Latine. Shumë njerëz, nga të gjitha shtresat dhe me sfond të ndryshëm fetar, arritën të bënin, me ndihmën e saj, përparime të mëdha në fushën shpirtërore. Megjithëse nuk ekziston asnjë organizatë zyrtare për përhapjen e doktrinës së saj, ekzistojnë në mbarë botën nxënës e shokë të saj, që janë gati të ndihmojnë të gjithë ata që duan të mësojnë nga Mjeshtrja e tyre e dashur.

Mjeshtrja Ching Hai na tregon, se nuk ka qenë gjithmon e ndritësuar. Ajo bënte një jetë normale dhe njëhte, nga përvoja e vet, problemet, dëshirat, qejfet, dyshimet si dhe vuajtjet e zemrave tona. Ajo njuh sferat qiellore të budizmit dhe di si shkohet atje. Në këtë fazë të jetës, ajo sheh si detyrë të vetme të saj, të na ndihmojë ne në rrugën tonë të mundimshme e të ngatërruar, jashtë gjëndjes së të qenit zgjuar si dhe të na çoj në lumturi, qartësi absolute të realitetit hyjnor. Nëqoftëse jeni gati, ajo mund t'ju çojë juve atje.

Mjeshtrja Ching Hai mban referate para nxënësve të interesuar pavarësisht nëse janë katolik, musliman, budist, apo taoist. Ajo flet anglisht, frengjisht, gjermanisht, kinezisht dhe atë aulake. Ata që dëshirojnë të mësojnë metodën e

Kuan Jin-it dhe ta zbatojnë atë me mjeshtren Ching Hai, mund të mësohen nga ajo. Referatet dhe mësimi i saj jepen falas.